



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

OPINION

KOMENTE DHE SUGJERIME MBI RAPORTIN VJETOR TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT, PËR VITIN 2021

Në zbatimin e misionit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të ndryshme kemi patur një bashkëpunim pozitiv dhe konstruktiv, me institucionin e Avokatit të Popullit (AP). Ky bashkëpunim është shtrirë në disa drejtime, si në realizimin e misioneve të përbashkëta të monitorimit tematik në institucionet e mbyllura të sistemit penitenciar në vendin tonë, në përfaqësimin e interesit publik në çështjet të cilat kanë investuar Gjykatën Kushtetuese, në pjesëmarrjen periodike dhe reciproke në aktivitete të ndryshme të realizuara nga Avokati i Popullit dhe KShH, me fokus të drejtat dhe liritë themelore të grupeve të marginalizuara të shoqërisë etj.

Në krye të herës, KShH vlerëson pozitivisht bashkëpunimin e shfaqur nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit kundrejt shoqërisë civile, tregues i një qasje të hapur dhe llogaridhënëse (një element i trajtuar në mënyrë të detajuar në seksionin 5.3 të Raportit).

Në kuadër të konsultimit publik të Raportit Vjetor 2021 të hartuar nga institucioni i Avokatit të Popullit (AP), vlerësojmë që të ndajmë disa komente/sugjerime, të cilat mund të shërbejnë sadopak në përmirësimin e reflektimit të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve që bashkë-shoqërojnë aktivitetet e mandatin tepër të rëndësishëm kushtetutes të Institucionit të Pavarur të Avokatit të Popullit:

- a) Referuar marrjes së masave nga ana AP, për krijimin e blogut për reflektimin e historive të suksesit si pjesë e faqes zyrtare të institucionit, një rekomandim i përcjellë nëpërmjet Rezolutës së Kuvendit për vitin 2020, KShH sugjeron reflektimin e mëtejshëm në Raport të impaktit sa i takon suksesit të rekomandimeve të adresuara, përkatësisht nga numri maksimal i rekomandimeve të adresuara nga secili prej 5 seksioneve funksionale pranë AP. Gjithashtu, është e rekomandueshme që në faqen zyrtare të institucionit, historitë e suksesit të kategorizohen sipas viteve të cilat i përkasin rekomandimet e adresuara.
- b) - Duke mirëkuptuar sfidën e pasqyruar nga vetë institucioni i Avokatit të Popullit, mbi burimet financiare të kufizuara për realizimin e fushatave promovuese në terren, element i cili ka ndikuar që pjesa më e madhe e veprimtarive promovuese të jetë realizuar nëpërmjet rrjetit social Facebook apo aplikacionit të ngritur;
- Duke mbajtur në konsideratë zhvillimin e konsiderueshëm dhe sferën e rëndësishme që po fiton teknologjia;

KShH sugjeron që të mbahen në konsideratë në çdo rast edhe kushtet socio-ekonomike të pjesës më të madhe të shoqërisë në vendin tonë, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabel dhe atyre të marginalizuara të shoqërisë. Kjo situatë reflekton akses të kufizuar të këtyre shtetasve në mjetet



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dhe platformat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit elektronik, fakt i cili është dokumentuar edhe nëpërmjet numrit prej 9.6% e ankesave të adresuara AP nëpërmjet aplikacionit. Sugjerohet gjithashtu evidentimi i të dhënave statistikore si rrjedhojë e rritjes së numrit të ndjekësve në faqen zyrtare të institucionit në Facebook.

- c) Duke vlerësuar rolin dhe kontributin e rëndësishëm që i është dhënë të rinjve e të miturve nga ana e Seksionit të Përgjithshëm lidhur me fenomenin e dhunës në familje, dhe nga ana e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, referuar abuzimit seksual të të miturve, si dhe duke mbajtur në konsideratë që këto raporte i janë përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë prej Janarit të vitit 2021 dhe Janarit të këtij viti (2022), KShH do të sugjeronte që AP të pasqyronte dhe të vinte theksin në masat e marra dhe nivelin e reflektimit nga Kuvendi, referuar gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të adresuara nëpërmjet këtyre dy raporteve, të cilat prekin fenomene të rëndësishme e që meritojnë një vëmendje të shtuar të Kuvendit si organ ligjberës por edhe mbikqyrës për zbatimin e ligjeve të miratuara prej tij.
- d) Duke mbajtur në konsideratë masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të ECRI-t, referuar bashkëpunimit reciprok të AP dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, KShH sugjeron evidentimin në këtë raport edhe të dhënave statistikore të ankesave të adresuara dhe të trajtuara nga KMD, në zyrat rajonale.
- e) Referuar përmbledhjes së veprimtarisë së Seksionit të Veçantë të AP (fq. 19-21), KShH do të sugjeronte reflektimin e një analize të përmbledhur cilësore të të dhënave statistikore të reflektuara për vitet 2020-2021. Duke qenë se kemi një rritje të numrit të nën-rekomandimeve (27 më shumë se në vitin 2020), por nga ana tjetër përgjysmim të numrit të inspektimeve/monitorimeve (24 më pak në raport me vitin 2020), do të ishte ndihmuese për publikun që të reflektohej ndërlidhja ndërmjet këtyre treguesve, të cilat mund të nxjerrin në pah suksesin dhe efektivitetin e mjeteve të tjera të monitorimit e adresimit të rekomandimeve, zëvendësuese tashmë të misioneve verifikuese/inspektuese. I njëjti sugjerim vlen edhe për të dhënat e reflektuara nga ana e Seksionit të Administratës (fq. 24-25).
- f) Referuar rekomandimit të adresuar nga ana e AP-së, pranë institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, për dërgimin për konsultim të Projekt Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe projektligjin "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10221, date 04.02.2020 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", KShH sugjeron marrjen e masave konkrete nga ana e AP për verifikimin në natyrë *folloë up* (ndjekje efektive dhe brenda afateve të arsyeshme) të nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të adresuara nga ana e AP, institucioneve publike si dhe rritjen e nivelit të reagimit publik kur këto rekomandime nuk zbatohen¹.

¹ Psh: në rastin konkret, KShH nuk është përfshirë në asnjë proces konsultimi, pas datës së nxjerrjes së rekomandimit përkatës nga ana e institucionit të AP. Një takim konsultues online i mbajtur më dt. 11.12.2020, është shoqëruar me përcjelljen e komenteve/sugjerimeve nga ana jonë mbi draft-Rregulloren e përgjithshme të Burgjeve të konsultuar, në rrugë elektronike në adresë të MD-së më dt. 18.12.2020. Pas këtij takimi, KShH nuk është informuar mbi asnjë përgjigje zyrtare lidhur me nivelin e reflektimit apo përshtatjes së komenteve/sugjerimeve të adresuara në versionin final të Rregullores së Përgjithshme të miratuar.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- g) Sa i përket të drejtave të personave të privuar nga liria (seksioni 3.2.) dhe respektimit të të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit (seksioni 3.3.), KShH sugjeron unifikimin e mënyrës së analizës cilësore ndërmjet këtyre dy seksioneve të cilat në fokus të përbashkët kanë shtetasit e ndodhur në institucionet e mbyllura. Gjithashtu sugjerohet të evidentohet po në mënyrë të unifikuar edhe niveli i pranueshmërisë nga ana e institucioneve ligjzbatuese, të cilave ju janë adresuar rekomandimet respektive të AP. KShH sugjeron shmangien e citimeve periodike të të njëjtave rrethana faktike dhe përmbledhjen e këtij rasti edhe rekomandimeve respektive në njërën prej seksioneve².
- h) Referuar analizës së rasteve të parashikuara në seksionin ‘të drejtat ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit’ (fq. 45-46), në përmbushje të neneve 22/1 dhe 23 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, KShH sugjeron marrjen e masave si një formë reagimi në rast mos bashkëpunimi nga autoritetet publike. Kjo formë reagimi, me vizibilitet më të shtuar në publik vlerësojmë se do ndikonte pozitivisht në forcimin dhe rritjen e rolit të AP, kundrejt qytetarëve, të cilët besojnë në mandatin e këtij institucioni kushtetues.
- i) Në analizë të pikave 4) dhe 5) të gjetjeve të konstatuara nga MKPT në inspektimet në institucionet penitenciare (fq. 48-49), KShH rekomandon ndarjen e një qëndrimi apo opinionit nga AP, lidhur me proporcionalitetin e numrit të stafit që do të kujdeset për shtetasit e transferuar në 2 godina e I EVP Shënkoll, Lezhë, në raport me numrin total të shtetasve me masë mjekësore të transferuar³.
- j) Duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e adresuara nga ana e AP, pranë KLGJ-së, KLP-së, ILD-së dhe Gjykatave, KShH sugjeron se një përmbledhje e analizës duhet të ishte referuar edhe në çështjen *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, trajtuar nga ana e GJEDNJ-së, e cila lidhet me kohëzgjatjen e gjykimeve në sistemin gjyqësor vendas në Shqipëri, kryesisht në Gjykatën e Lartë dhe efektet në Reformën në Drejtësi.
- k) Referuar ‘neglizhencës së theksuar’ të cituar nga ana e AP, lidhur me mungesën e bashkëpunimit të DHKA-së për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për akordimin e ndihmës juridike falas qytetarëve që kanë përmbushur kriteret dhe kushtet ligjore, si dhe përjashtimin e tyre nga taksat dhe tarifat gjyqësor (seksioni 3.7 i raportit), KShH sugjeron nevojën për reflektimin nga AP për zbatimin e nenit 27 të ligjit të posaçëm nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar. Duke qenë se kjo situatë e përsëritur krijon premisa objektiva dhe risk të shtuar për cënim të procesit të rregullt ligjor e garantimit efektiv të aksesit në drejtësi për qytetarët, KShH vlerëson se raportimi i veçantë drejtuar Kuvendit të RSH-së, mund të ndikonte sadopak në gjetjen e një zgjidhjeje oportune ligjore për këtë situatë të krijuar.
- l) Sa i përket seksionit ‘niveli i zbatimit të rekomandimeve’ (fq. 168), në të cilin

² Psh, rasti i vrasjes së të riut K.R. nga një efektiv i Policisë së Shtetit (cituar edhe në seksionin 3.3., por edhe në seksionin ku analizohet ‘e drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet’),

³ Në vështrimin e KShH-së, ky numër nuk është proporcional, ndërkohë që rekomandime konkrete të posaçme duhet të ishin adresuar, me qëllim garantimin e trajtimit të individualizuar mjekësor dhe psiko-social të shtetasve me masë mjekësore të vendosur në këto dy godina.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

reflektohen indikatorë sasiorë dhe cilësorë totalë të numrit të rekomandimeve të adresuara, KShH sugjeron se niveli në rritje i përqindjes së rekomandimeve pa përgjigje nga ana e institucioneve publike, pasqyron një situatë problematike në drejtim të nivelit të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së këtyre organeve, e cila mund të nënvizohet me nota shqetësuese në raportin vjetor. Në këtë këndvështrim, do të ishte e udhës që të citoheshin edhe institucionet publike të cilat përfshihen në kategoritë respektive.